



ÇËSHITJA E
REPARACIONEVE PËR KRIMET E LUFTËS
TË KRYERA NË **KOSOVË** NË KONTEKSTIN E
'FINALES SË MADHE' EVENTUALE
NDËRMJET
KOSOVËS DHE **SERBISË**



Sheshi Nënë Terezë, Hyrja I · 59A · Nr. 10
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
T/F: +383 38 746 206
E-mail: ridea.institute@gmail.com

STUDIM

MBI

ÇËSHTJEN E REPARACIONEVE PËR KRIMET E LUFTËS TË KRYERA NË KOSOVË NË KONTEKSTIN E 'FINALES SË MADHE' EVENTUALE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Nëntor 2019

STUDIM
MBI
ÇËSH TJEN E REPARACIONEVE PËR KRIMET E LUFTËS TË
KRYERA NË KOSOVË NË KONTEKSTIN E ‘FINALES SË
MADHE’ EVENTUALE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Ky studim u mbështet nga:



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Nëntor 2019

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Shkurtesat..... | i |
| <i>Përmbledhje:</i> | ii |
| I. Historiku | 1 |
| Ngjarjet që i kanë pararprirë shpërbërjes së dhunshme të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë..... | 1 |
| Zhvillimet pas vitit 1989 në Kosovë..... | 3 |
| Marrëveshjet e Rambujesë së vitit 1999..... | 10 |
| Ndërhyrja Ushtarake e NATO-s në Kosovë - Operacioni 'Forca Aleate' 24 mars - 10 qershor 1999..... | 11 |
| Rezoluta 1244 dhe Themelimi i Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë..... | 14 |
| Procesi i Negocimit të Statusit Final të Mbikëqyrur Ndërkombëtarisht..... | 15 |
| Deklarata e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008..... | 17 |
| II. Koncepti i Reparacioneve (dëmshtëpërblimit) në të Drejtën Ndërkombëtare | 18 |
| Parimet përmbajtësore për reparacionet sipas të drejtës ndërkombëtare..... | 18 |
| Parimet e Reparacionit sipas së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare..... | 23 |
| Parimet e Reparacionit sipas të Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut..... | 25 |
| Parimet e Reparacionit sipas të Drejtës Ndërkombëtare Penale..... | 33 |
| Shënime Përfundimtare..... | 36 |
| III. Llojet dhe Madhësia e Reparacioneve për t'u bërë | 37 |
| Vrasjet..... | 38 |
| Personat e Zhdukur..... | 39 |
| Të burgosurit..... | 40 |
| Shkatërrimi i pronës..... | 41 |
| Dhunimi dhe Format e Tjera të Dhunës Seksuale..... | 42 |
| Dëbimi i shqiptarëve të Kosovës nga forcat serbe / jugosllave dhe pasiguria mentale dhe fizike..... | 44 |
| IV. Përfundime | 49 |
| Garancitë e mospërsëritjes..... | 50 |
| Kthimi (veçanërisht i pronës)..... | 50 |
| Kompensimi..... | 50 |
| Satisfaksioni (Kërkim-falja)..... | 52 |

Shkurtesat

| | |
|---------------|--|
| CAT | Konventa kundër Torturës |
| CEELI | Iniciativa Ligjore e Evropës Qendrore dhe Lindore |
| CERD | Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor |
| CPPED | Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyrueshme |
| GJND | Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë |
| GJPDN | Gjykata e Përhershme e Drejtësisë Ndërkombëtare |
| IACtHR | Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut |
| ICC | Gjykata Penale Ndërkombëtare |
| ICCPR | Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike |
| ICRC | Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq |
| ICTY | Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë |
| IDP | Personat e Zhvendosur brenda vendit |
| ILC | Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare |
| MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |
| NATO | Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut |
| OJQ | Organizata joqeveritare |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| RFJ | Republika Federale e Jugosllavisë |
| RSFJ | Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë |
| TFV | Fondi i Mirëbesimit për Viktima |
| UÇK | Ushtria Çlirimtare e Kosovës |
| UDHR | Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut |
| UJ | Ushtria e Jugosllavisë |
| UNHCR | Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë |
| UNMIK | Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë |

Përmbledhje:

Ky studim shqyrton shkallën e dëmeve dhe shkatërrimeve të shkaktuara nga autoritetet e Republikës së Serbisë—dhe, siç mund të jetë e aplikueshme, edhe ish Republika Federative e Jugosllavisë—në territorin e Kosovës që rrjedh nga krimet e luftës dhe nga mizoritë e tjera të lidhura me to nga autoritetet e përmendura. Metodologjia bazohet kryesisht në të dhëna autoritative, kualitative dhe kuantitative, të prodhuara dhe të publikuara nga medime të pavarura ose forume të institucionalizuara gjyqësore (p.sh. ICTY – Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë) ose të tjerë (p.sh., Human Rights Watch, Amnesty International) që kanë shfaqur specifikisht një shkallë të lartë objektiviteti në krijimin dhe prezantimin e fakteve përkatëse. Punimi fillon me një pasqyrë të zhvillimeve relevante që kanë përcaktuar rrethanat e veçanta në dhe rreth Kosovës, duke kulmuar me kryerjen e krimeve masive në vitin 1999. Pjesa e dytë pasuese diskuton konceptin e dëmshpërblimit në të drejtën ndërkombëtare; dhe e bën këtë nga këndvështrimet e nën-disiplinave siç janë e drejta ndërkombëtare humanitare, e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe e drejta ndërkombëtare penale. Qëllimi përfundimtar është të përcaktojë rolin dhe statusin e reparacioneve ose dëmshpërblimit në të drejtën ndërkombëtare, me një fokus dominues në detyrën e shtetit për të kompensuar shkeljet ose dëmet e shkaktuara ndaj qenieve njerëzore individuale, të konceptuara në të njejtën kohë si një subjekt i patjetërsuar në të drejtën ndërkombëtare. Pjesa e III-të pastaj vazhdon me një diskutim për dëmet specifike njerëzore (fizike dhe mentale) dhe dëmet materiale të shkaktuara si rezultat i mizorive të kryera nga autoritetet e shtetit të Serbisë në territorin e Kosovës. Pjesa e IV-të prezanton vërejtjet përmblyëse, duke identifikuar mënyrat e mundshme për dëmshpërblim.

I. Historiku

Ngjarjet që i kanë paraparirë shpërbërjes së dhunshme të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë

1. Jugosllavia ndryshoi emrin dhe kuadrin kushtetues disa herë që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1946, Jugosllavia Federale Demokratike ndryshoi emrin e saj në Republikën Popullore Federale të Jugosllavisë. Sipas kushtetutës së vitit 1946, Kosova ishte pjesë e Republikës Popullore të Serbisë dhe iu dha statusi i rajonit autonom.¹ Më 1963, vendit ju ndryshua emri në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë (në tekstin e mëtejme "RSFJ"). Sipas kushtetutës së vitit 1963, statusi i Kosovës u transformua nga ai i një rajoni autonom në atë të një krahine autonome.²
2. Në vitin 1974, Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë u miratua për të zëvendësuar Kushtetutën e vitit 1963. RSFJ-ja u përcaktua me Kushtetutën e vitit 1974 si një bashkësi shtetërore e kombeve vullnetare dhe republikave të tyre socialiste, si dhe krahinave autonome të Kosovës dhe Vojvodinës, ishin të përfaqësuara në nivelin federal dhe atë të Republikës Socialiste të Serbisë.³

¹ Neni 2 i Kushtetutës së 1946, në M. Weller, *The Crisis in Kosovo 1989-1999*, Documents and Analysis Publishing Ltd, shtator 1999, fq. 52.

² Shih Nenet 111 dhe 112 në Kushtetutën e 1963, në M. Weller, *The Crisis in Kosovo 1989-1999*, Documents and Analysis Publishing Ltd, shtator 1999, fq. 53.

³ Neni 1 i Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë Constitution, në H. Krieger, *The Kosovo Conflict and International Law: An Analytical Documentation 1974-1999: An Analytical Documentation 1974-1999* (Cambridge International Documents Series), Cambridge University Press, 2001, fq. 2 (më poshtë Krieger) dhe në M. Weller, *The Crisis in Kosovo 1989-1999*, Documents and Analysis Publishing Ltd, shtator 1999, fq. 54. Ky nen thotë: "Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë është një shtet federal që ka formën e një bashkësie shtetërore të kombeve vullnetare të bashkuara dhe republikave të tyre socialiste dhe të provincave autonome socialiste të Vojvodinës dhe Kosovës, të cilat janë pjesë përbërëse e Republikës së Serbisë, bazuar në fuqinë e vetëqeverisjes nga klasa punëtore dhe nga të gjithë njerëzit që punojnë; në të njëjtën kohë është një komunitet socialist vetëqeverisës demokratik i njerëzve dhe qytetarëve që punojnë dhe të kombeve dhe kombësive që kanë të drejta të barabarta."

Sipas Kushtetutës së vitit 1974, Kosova kishte Kushtetutën e saj, Gjykatën Kushtetuese dhe të Lartë, Parlamentin e saj dhe Komitetin Ekzekutiv.⁴ Për më tepër, Kosova kishte përfaqësues në Dhomën e Republikave dhe Provincave të RSFJ-së dhe në Dhomën Federale dhe gjithashtu u përfaqësua në Presidencën Federale.

3. Siç u tha nga Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë (ICTY) në aktgjykimin e saj të 26 shkurtit 2009 në rastin e *Milutinović dhe të tjerët*:

Sipas Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ("RSFJ"), e shpallur në shkurt 1974, RSFJ përbëhej nga gjashtë republika dhe dy krahina autonome. Të dyja këto krahina - Kosova dhe Vojvodina - formuan pjesë të Republikës Socialiste të Serbisë. Kjo Kushtetutë u dha krahinave një shkallë të konsiderueshme autonomie, e cila përfshinte fuqinë për të hartuar kushtetutat e tyre, të kenë gjykatat e tyre kushtetuese, të kenë një përfaqësues në Presidencën e RSFJ-së në Beograd dhe të drejtën për të nisur procedurat para gjykatave kushtetuese të Jugosllavisë dhe Serbisë. Përveç kësaj, ato u përfaqësuan, së bashku me republikat, në Dhomën e republikave dhe krahinave të RSFJ-së dhe në Dhomën Federale, e cila ishte organi legjislativ me fuqi për të ndryshuar kushtetutën e RSFJ-së.⁵

4. Sipas nenit 245 të Kushtetutës së vitit 1974, kombet dhe kombësitë e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë kishin të drejta të barabarta.⁶ Veç kësaj, vlen të përmendet se sipas nenit 5, territori i një Republike nuk mund të ndryshohej pa pëlqimin e asaj republike dhe territori i një Province Autonome - pa pëlqimin e asaj

⁴Neni 4 i Kushtetutës së vitit 1974 thotë: "Provinat Autonome Socialiste janë bashkësi socio-politike demokratike vetë-udhëheqëse autonome, të bazuara në fuqinë e vetëqeverisjes nga klasa punëtore dhe të gjithë njerëzve që punojnë, ku njerëzit, kombet dhe kombësitë që punojnë realizojnë të drejtat e tyre sovrane, dhe përcaktohen në mënyrë të tillë nga Kushtetuta e Republikës Socialiste të Serbisë në interesin e përbashkët të popullit, kombeve dhe kombësive të asaj republike si një e tërë, e bëjnë këtë edhe brenda Republikës." Në Krieger, fq. 3.

⁵ *Prosecutor v. Milan Milutinović, Nikola Šainović, Dragoljub Ojdanić, Nebrojša Pavković, Vladimir Lazarević, Sreten Lukić* (IT-05-87-T), *Judgment*, 26 Shkurt 2009. Në dispozicion në: <http://www.icty.org/case/milutinovic/4#tjug>.

⁶ Shih Krieger, p. 3.

Province Autonome.⁷ Kjo është përforcuar në paragrafin e fundit të atij Neni, ku thuhet: “Kufijtë ndërmjet republikave mund të ndryshohen vetëm në bazë të marrëveshjes së përbashkët dhe nëse përfshihet kufiri i një Province Autonome, gjithashtu në bazë të marrëveshjes së kësaj të fundit.”⁸ Kjo do të thotë se, në mesin e të drejtave të tjera, krahinat autonome gëzonin sovranitet mbi territorin e tyre në të njëjtin nivel me Republikat që përbëjnë shtetin federal.

Zhvillimet pas vitit 1989 në Kosovë

5. Në vitin 1989, autoritetet serbe revokuan autonominë e Kosovës kundër vullnetit dhe pëlqimit të popullit të Kosovës.⁹ Aktet anti-kushtetuese të qeverisë serbe për ta detyruar me forcë integrimin e Kosovës në Serbi shënuan edhe pikënisjen e shpërbërjes së RSFJ-së.
6. Më 3 qershor 1990, Serbia miratoi ligjin mbi veprimin e organeve të Republikës në rrethana të veçanta në Kosovë.¹⁰ Pothuajse 300 drejtorë shqiptarë u liruan nga masat e detyrueshme që u vunë në zbatim. Më 5 korrik 1990, Serbia miratoi ligjin mbi pavlefshmërinë e veprimtarisë së Kuvendit të Kosovës dhe të qeverisë së saj.¹¹
7. Më 26 Korrik, 1990, Serbia kaloi ligjin për marrëdhëniet e punës në rrethana të veçanta.¹² Me atë ligj, 135,000 punëtorë shqiptarë u dëbuan nga vendet e punës. Më tej, të gjitha aktivitetet në gjuhën shqipe u ndaluan, duke filluar nga edukimi, kultura,

⁷ Shih Krieger, p. 3.

⁸ Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Gazeta Zyrtare e RSFJ Nr. 9/1974, art. 5

⁹ Shih Krieger, fq. 8.

¹⁰ *Ligji mbi Veprimet e Agjencive Republikane nën Rrethanat e Veçanta*, 26 qershor 1990, Gazeta Zyrtare e SSRS, 33/90, në M. Eëller, *The Crisis in Kosovo 1989-1999*, Documents and Analysis Publishing Ltd, shtator 1999, pp. 60-61.

¹¹ *Ligji Përfundon Punën e SAP të Kuvendit të Kosovës dhe Këshillit Ekzekutiv*, 5 korrik 1990, në M. Weller, *The Crisis in Kosovo 1989-1999*, Documents and Analysis Publishing Ltd, shtator 1999, pp. 61-62. Shih edhe *Rregulloren e Kuvendit të Serbisë mbi Zbatimin e Ligjit që Përfundon Punën e SAP Kuvendit të Kosovës dhe Këshillit Ekzekutiv*, 13 korrik 1990, në M. Weller, *The Crisis in Kosovo 1989-1999*, Documents and Analysis Publishing Ltd, shtator 1999, fq. 62.

¹² *Ligji për Marrëdhëniet e Punës nën Rrethana të Veçanta*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, No. 22/91, në M. Weller, *The Crisis in Kosovo 1989-1999*, Documents and Analysis Publishing Ltd, shtator 1999, pp. 62-63.

shkenca, dhe media, ndërsa personeli shqiptar që punonte në sektorë të tillë si shkollat, universitetet, institucionet shëndetësore, mediat, policia dhe sektorë të tjerë relevant u shkarkuan në masë. Gjatë këtij viti, më shumë se 7,000 nxënës shqiptarë u helmuan.

8. Duke reaguar ndaj veprimeve të udhëheqjes serbe, anëtarët e Kuvendit të Kosovës miratuan Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës më 2 korrik 1990. Kjo deklaratë parapriu Kushtetutën e Republikës së Kosovës, miratuar më 7 shtator 1990. Një referendum i pavarësisë u organizua gjithashtu në Kosovë nga 26 shtatori deri më 30 shtator 1990, pas heqjes së statusit autonom të Kosovës nga Serbia në vitin 1989. Nga 87 përqind e popullatës që mori pjesë në referendum, 99.87 përqind votuan për pavarësinë e Kosovës.¹³
9. Dy ligje të miratuara më 1992 e bën gjuhën serbe gjuhë të mësimdhënies në Kosovë për shkolla fillore dhe të mesme.¹⁴ Serbia ndërpreu financimin e edukimit në gjuhën shqipe. Deri në mars 1991, 21,000 mësimdhënës u shkarkuan nga puna.¹⁵ Ngjashëm edhe 1,885 mjekë dhe staf tjetër mjekësor humbën vendet e tyre të punës.
10. Shtypja dhe shkelja sistematike e të drejtave themelore të njeriut dhe lirive themelore ishte një dukuri e përditshme në Kosovë.

¹³ Shih D. Bethlehem dhe M. Weller (eds.), *The 'Yugoslav' Crisis in International Law: General Issues Part I*, Cambridge International Documents Series Volume 5, Cambridge University Press, 1997, fq. xxx.

¹⁴ Shih *Ligji për Shkollën Fillore*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, Nr. 50/92 dhe *Ligji për Shkollën e Mesme*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, Nr. 50/92, në M. Weller, *The Crisis in Kosovo 1989-1999*, Documents and Analysis Publishing Ltd, shtator 1999, fq. 63. Është e rëndësishme të theksohet edhe *Ligji për Shkollën e Lartë*, *ibidem*.

¹⁵ Shih *ndër të tjera* D. Kostovicova, *Parallel Worlds: Response of Kosovo Albanians to Loss of Autonomy in Serbia, 1989-1996*, Keele University Press, fq. 33-35.

Është raportuar që midis viteve 1990 dhe 1995 mbi treqind mijë shqiptarë të Kosovës e kishin lënë Kosovën nga frika e persekutimit apo e arsyeve ekonomike.¹⁶

- 11.** Prej vitit 1992 deri më 1998 Asambleja e Përgjithshme ka kaluar një numër rezolutash duke pranuar dhe dënuar shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut që po ndodhnin në Kosovë.¹⁷ Në Rezolutën 48/153 të 20 dhjetorit 1993, duke shprehur shqetësim të madh lidhur me situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë, Asambleja e Përgjithshme fuqishëm dënoi: [në mënyrë të veçantë masat dhe praktikatat e diskriminimit dhe shkeljet e të drejtave të njeriut të shqiptarëve etnik të Kosovës, si dhe represionin në shkallë të gjerë i kryer nga autoritetet serbe duke përfshirë: (a) Brutalitetin policor kundër shqiptarëve etnik të Kosovës, kërkimet e dhunshme, kapjet dhe arrestimet, torturat dhe keqtrajtimet gjatë paraburgimit dhe diskriminimi në administratën e drejtësisë, që çon në një klimë të paligjshmërisë në të cilën veprimet kriminale, në veçanti kundër shqiptarëve etnik, ndodhin pa u ndëshkuar; (b) Largimi diskriminues i zyrtarëve shqiptarëve etnik, sidomos nga policia dhe gjyqësori, shkarkimi masiv i shqiptarëve etnik nga pozitat profesionale, administrative, dhe pozita të tjera të kualifikuara në ndërmarrjet shtetërore dhe institucioneve publike, duke përfshirë mësuesit nga sistemi shkollor i drejtuar nga serbët, dhe mbyllja e shkollave të mesme dhe universiteteve shqiptare; (c) Burgimi arbitrar i gazetarëve shqiptarë, mbyllja e mediave në gjuhën shqipe, dhe largimi diskriminues nga puna i stafit shqiptarë nga radiot lokale dhe stacionet televizive; (d) Represioni nga policia dhe ushtria serbe.”

¹⁶Shih, *ndër të tjera*, Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Raporti Pranveror i Kosovës, 20 mars 1998, f. 5. Në dispozicion në: http://www.crisisgroup.org/library/documents/report_archive/A400178_20031998.pdf; Projekti Minoritetet Në Rrezik(Qendra e Universitetit të Maryland për Zhvillim Ndërkombëtar dhe Menaxhim Konflikti) *Kronologjia për shqiptarët e Kosovës në Jugosllavi*, gjendet në: <http://www.cidcm.umd.edu/mar/chronology.asp?groupId=34501>. Në paragrafin përkatës thuhet: "Shqiptarët etnikë vazhduan të largoheshin nga vendet e punës të kontrolluara nga ndërmarrjet shtetërore në muajin mars. Milicia serbe, e udhëhequr nga Zheljko Raznjatoviq, shtoi ngacmimet ndaj shqiptarëve të Kosovës në atë që quajtet nga udhëheqësit kosovarë 'spastrimi etnik në heshtje'. Rezultatet pohuan se emigrimi shqiptar nga Kosova raportohet të jetë deri në 500,000."

¹⁷ Shih *ndër të tjera* Krieger, fq. 15-25, M. Weller, *The Crisis in Kosovo 1989-1999*, Documents and Analysis Publishing Ltd, shtator 1999.

12. Në të njëjtën rezolutë, Asambleja e Përgjithshme gjithashtu u bëri thirrje autoriteteve të Republikës Federative të Jugosllavisë: “(a) Të marrin të gjitha masat e nevojshme që të marrin fund menjëherë shkeljet e të drejtave të njeriut që u shkaktohen shqiptarëve etnik në Kosovë, duke përfshirë në veçanti, masat dhe praktikatat diskriminuese, ndalesat arbitrare dhe përdorimi i torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese si dhe shfaqjen e ekzekutimeve të përgjithshme; (b) Të revokojë të gjithë legjislacionin diskriminues, në veçanti atë që ka hyrë në fuqi që nga viti 1989; (c) Të rivendosë institucionet demokratike të Kosovës, përfshirë Parlamentin dhe gjyqësorin; (d) Të vazhdojë dialogun me shqiptarët etnik në Kosovë, të përfshirë nën patronazhin Konferencës Ndërkombëtare të ish-Jugosllavisë.”
13. Në rezolutën e saj 49/204 të 23 dhjetorit 1994, Asambleja e Përgjithshme vuri në dukje brutalitetin e policisë kundër shqiptarëve etnik, vrasjen e shqiptarëve etnik që rezultoi nga kjo dhunë, kërkime arbitrare, konfiskime dhe arrestime, dëbime me forcë, tortura dhe keqtrajtim të të paraburgosurve dhe diskriminimin në administrimin e drejtësisë; diskriminimin dhe shkarkimin arbitrar të nëpunësve civil etnik shqiptarë, veçanërisht nga radhët e policisë dhe gjyqësorit, shkarkimet masive të shqiptarëve etnik, konfiskimin dhe shpronësimin e pronave të tyre, diskriminimin ndaj nxënësve dhe mësuesve shqiptarë, mbylljen e shkollave të mesme të gjuhës shqipe dhe universitetin, si dhe mbylljen e të gjitha institucioneve kulturore dhe shkencore shqiptare; ngacmimet dhe përndjekjet e partive politike dhe shoqatave të shqiptarëve etnik, udhëheqësve dhe aktiviteteve të tyre, keqtrajtimin dhe burgosjen e tyre; frikësimin dhe burgosjen e gazetarëve shqiptarë etnik dhe ngacmimin sistematik dhe ndërprerjen e mediave informuese në gjuhën shqipe; shkarkimet nga klinikat dhe spitalet e mjekëve dhe anëtarëve të kategorive të tjera të profesionit mjekësor me origjinë shqiptare; eliminimi në praktikë i gjuhës shqipe, veçanërisht në administratën publike dhe shërbime publike; shfaqja serioze dhe masive e praktikave diskriminuese dhe shtypëse që kanë për synim shqiptarët në Kosovë si të tërë, duke rezultuar në një migrim të pavullnetshëm të përhapur;

dhe duke vënë në dukje gjithashtu që Nënkomisioni për Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjes së Minoriteteve, në rezolutën e saj 1993/9 të 20 gushtit 1993, konsideroi se këto masa dhe praktika përbënin një formë të spastrimit etnik.

14. Më 22 dhjetor 1995, Asambleja e Përgjithshme miratoi Rezolutën 50/190, duke vënë në dukje masa të ndryshme diskriminuese të marra në fushat legislative, administrative dhe gjyqësore, aktet e dhunës dhe arrestimet arbitrare të kryera kundër shqiptarëve etnik në Kosovë dhe përkeqësimin e vazhdueshëm të gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë, duke përfshirë: brutalitetin policor kundër shqiptarëve etnik, vrasjen e shqiptarëve etnik që rezultojnë nga një dhunë e tillë, kërkime arbitrare, konfiskime dhe arrestime, dëbime me forcë, torturë dhe keqtrajtim të të ndaluarve dhe diskriminim në administrimin e drejtësisë, duke përfshirë gjykimet e fundit të ish-policëve shqiptarë etnik; diskriminimi dhe largimi arbitrar i shërbyesve etnik shqiptarë, veçanërisht nga radhët e policisë dhe gjyqësorit, shkarkimet masive të shqiptarëve etnik, konfiskimi dhe shpronësimi i pronave të tyre, diskriminimi ndaj nxënësve dhe mësuesve shqiptarë etnik, mbyllja e shkollave të mesme të gjuhës shqipe dhe universitetin, si dhe mbylljen e të gjitha institucioneve kulturore dhe shkencore shqiptare; ngacmimet dhe persekutimet e partive politike dhe shoqatave të shqiptarëve etnik, udhëheqësve dhe aktiviteteve të tyre, keqtrajtimit dhe burgosjes së tyre; frikësimin dhe burgosjen e gazetarëve shqiptarë etnik dhe ngacmimin sistematik dhe ndërprerjen e mediave të lajmeve në gjuhën shqipe; shkarkimet nga klinikat dhe spitalet e mjekëve dhe anëtarëve të kategorive të tjera të profesionit mjekësor të origjinës shqiptare; eliminimi në praktikë i gjuhës shqipe, veçanërisht në administratë dhe shërbime publike; shfaqja serioze dhe masive e praktikave diskriminuese dhe represive që synojnë shqiptarët etnik në Kosovë si një e tërë, duke rezultuar në një migrim të pavullnetshëm të përhapur.
15. Më 12 dhjetor 1996, Asambleja e Përgjithshme miratoi Rezolutën 51/111, me të cilën ajo: “1. Dënon të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë, në veçanti shtypjen e popullatës etnike shqiptare dhe diskriminimin kundër tyre, si dhe të

gjitha aktet e dhunës në Kosovë; 2. Kërkon që autoritetet e Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbisë dhe Malit të Zi): (a) Të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'i dhënë fund menjëherë të gjitha shkeljeve të të drejtave të njeriut kundër shqiptarëve etnik në Kosovë, veçanërisht masat dhe praktikët diskriminuese, dhe ndalimit, shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe praktikës së torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese dhe të revokojë të gjitha ligjet diskriminuese, në veçanti ato që kanë hyrë në fuqi që nga viti 1989; (b) Lirim të të gjithë të burgosurve politikë dhe ndërprerjen e persekutimit të udhëheqësve politikë dhe anëtarëve të organizatave lokale të të drejtave të njeriut; (c) Lejon krijimin e institucioneve të mirëfillta demokratike në Kosovë, duke përfshirë parlamentin dhe gjyqësorin, dhe respekton vullnetin e banorëve të saj si mjetin më të mirë për të parandaluar përshkallëzimin e konfliktit atje; (d) Lejon rihapjen e institucioneve edukative, kulturore dhe shkencore të shqiptarëve etnik; (e) Të vazhdohet dialogu konstruktiv me përfaqësuesit e shqiptarëve etnik të Kosovës [...]”).

16. Në rezolutën 52/139 të 12 dhjetorit 1997, Asambleja e Përgjithshme shprehu shqetësimin e saj për të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Kosovë, në veçanti represionit të popullatës etnike shqiptare dhe diskriminimit kundër saj, si dhe akteve të dhunës në Kosovë. Asambleja u bëri thirrje autoriteteve të RFJ-së: të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'i dhënë fund menjëherë të gjitha shkeljeve të të drejtave të njeriut kundër shqiptarëve etnik në Kosovë, duke përfshirë në veçanti masat dhe praktikët diskriminuese, kërkimet arbitrare dhe paraburgimin, shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe praktika e torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese dhe të revokojë të gjitha ligjet diskriminuese, veçanërisht atë që ka hyrë në fuqi që nga viti 1989; të lirojë të gjithë të burgosurit politikë dhe ndërprerjen e persekutimit të udhëheqësve politikë dhe anëtarëve të organizatave lokale të të drejtave të njeriut; të lejoj kthimin e sigurt dhe dinjitetin e refugjatëve shqiptarë nga Kosova në shtëpitë e tyre; të lejojë krijimin e institucioneve të mirëfillta demokratike në Kosovë, duke përfshirë parlamentin dhe gjyqësorin, si dhe të respektojë vullnetin e banorëve të saj si mjeti

më i mirë për të parandaluar eskalimin e konfliktit atje; për të lejuar rihapjen e institucioneve arsimore, kulturore dhe shkencore të shqiptarëve etnik.

17. Në tetor të vitit 1997, Raportuesi Special i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në ish-Jugosllavi, Elizabeth Rehn, vizitoi Kosovën për të hetuar akuzat për abuzimin e të drejtave të shqiptarëve. Në fund të vizitës së saj, Rehn tha se kishte gjetur dëshmi se policia serbe ishte fajtores për “brutalitet, me përdorim të shpeshtë të torturës” derisa trajtonte shqiptarët e arrestuar.¹⁸

18. Në dhjetor të vitit 1997, si rezultat i zhgënjimit në mesin e popullatës civile nga persekutimi dhe represioni i tyre sistematik nga ana e autoriteteve dhe si rezultat i mosveprimit nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) bëri paraqitjen e saj të parë publike dhe filloi rezistencën e saj të armatosur kundër forcave serbe në Kosovë. Ofenzivat më të mëdha të policisë serbe dhe forcave të ushtrisë jugosllave ndoqën këto zhvillime. Sulmi i parë i madh ishte në rajonin e Drenicës në shkurt / mars 1997. Një tjetër sulm ofensiv u nis në zonën kufitare me Shqipërinë.

19. Më 27 shkurt 1998, forcat serbe, duke përfshirë njësitë e blinduara dhe mbështetjen ajrore, sulmuan disa fshatra në rajonin e Drenicës. Një raport i Human Rights Watch arriti në përfundimin se një numër i madh i civilëve, përfshirë dhjetëra gra dhe fëmijë, vdiqën gjatë sulmit.¹⁹ Raporte të tjera nga organet dhe agjencitë e OKB-së japin informacion rreth shkallës dhe efektit të operacioneve policore dhe ushtarake të kryera nga policia serbe, forcat ushtarake dhe para-ushtarake në Kosovë. Ato

¹⁸Raporti i Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut për Situatën e të Drejtave të Njeriut në Kosovë, Republika Federale e Jugosllavisë, UN Doc. A / 52/490, në, *The Crisis in Kosovo 1989-1999*, Documents and Analysis Publishing Ltd, shtator 1999, fq. 177-180. Bazuar në atë raport, Komisioni për të Drejtat e Njeriut në Rezolutën e saj 1998/79 u bëri thirrje autoriteteve të RFJ-së që t'i japin fund torturës dhe keqtrajtimit të personave në paraburgim siç përshkruhet në raportet e raportuesit special dhe të sjellë përgjegjësit para drejtësisë.

¹⁹*Shkeljet e Ligjit Humanitar në Kosovë*, Raporti i Human Rights Watch, tetor 1998.

japin një pasqyrë të detajuar të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe së drejtës humanitare kundër popullatës civile.²⁰

20. Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët (më poshtë UNHCR) *raportoi në fillim të qershorit 1998 se operacioni detyroi më shumë se 40,000 shqiptarë etnik të largohen nga shtëpitë e tyre dhe të iknin për të shpëtuar jetën e tyre.*²¹ I dërguari i posaçëm i Presidentit të SHBA për ish Jugosllavinë, Robert Gelbard, i tha një komiteti të Senatit se çfarë po bënin forcat serbe “tingëllon tmerrësisht ngjashëm me spastrim etnik, pasi ata janë përpjekur t'i dëbojnë njerëzit nga Kosova për në Shqipëri.”

Marrëveshjet e Rambujesë së vitit 1999

21. Ndërsa situata në terren ishte kritike dhe shkeljet e të drejtave të njeriut vazhdonin, një konferencë e sponsorizuar ndërkombëtarisht u mbledh në Rambouillet, Francë, në shkurt 1999. Qëllimi i konferencës ishte të siguronte një zgjidhje politike për konfliktin ose siç vetë dokumenti sugjeron, një marrëveshje të përkohshme për paqen dhe vetëqeverisjen në Kosovë.²² Mekanizmi për zgjidhjen përfundimtare të përfshirë në këtë dokument parashikonte që tre vjet pas hyrjes në fuqi të marrëveshjeve (Akordeve) do të mblidhej një takim ndërkombëtar për të përcaktuar një mekanizëm për zgjidhjen përfundimtare të Kosovës, në bazë të vullnetit të popullit, opinioneve të autoriteteve përkatëse, përpjekjeve të secilës palë në lidhje me zbatimin e marrëveshjeve dhe Aktit Final të Helsinkit.²³ Më 18 mars 1999, Marrëveshja u nënshkrua nga përfaqësuesit shqiptarë, por jo nga homologët e tyre serbë. U theksua se kjo marrëveshje është përfunduar nën patronazhin e

²⁰ Për raportet e Komisionit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Komisioneri i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut dhe Raportuesi Special për ish Jugosllavinë shih ndër të tjera M. Weller, *The Crisis in Kosovo 1989-1999*, Documents and Analysis Publishing Ltd, shtator 1999, fq. 158-185; Krieger, fq. 25-45 dhe 46-65; për raportet e OJQ-ve shih Krieger, fq. 90-118

²¹ UNHCR, *Kosovo Crisis Update, The Exodus*, 7 prill 1999. Në dispozicion në: <http://www.unhcr.org/neës/NEWS/3ae6b80eb.html>.

²² Teksti i plotë i Marrëveshjes së Rambujesë është në dispozicion në:

https://www.usip.org/sites/default/files/file/resources/collections/peace_agreements/kosovo_ramb.pdf.

²³ Neni I: Amandamenti dhe Vlerësimi Gjithëpërfshirës, Marrëveshja e Rambujesë: Amandamenti, Vlerësimi Gjithëpërfshirës dhe Klauzolat Përfundimtare.

anëtarëve të Grupit të Kontaktit dhe Bashkimit Evropian dhe duke marrë për bazë lidhjen me këta anëtarë dhe Bashkimin Evropian që të respektojnë këtë Marrëveshje.

22. Ashtu si edhe dokumenti me fakte (*fact sheet*) lëshuar më 1 mars 1999, nga Byroja për Çështje Evropiane, Departamenti Amerikan i Shtetit, Uashington DC sugjeron që, Akordet e Rambujesë të sigurojnë një marrëveshje të përkohshme 3 vjeçare që do të siguronte vetëqeverisje demokratike, paqe dhe siguri për të gjithë që jetojnë në Kosovë.²⁴ Marrëveshja parashikon që zgjidhja përfundimtare e statusit të Kosovës do të përcaktohet në bazë të vullnetit të popullit të Kosovës. Përkundër faktit se kjo marrëveshje nuk u nënshkrua nga Serbia, Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit i referohet asaj. Pjesa përkatëse e Aneksit 1 të rezolutës, duke renditur një numër parimesh të përgjithshme për zgjidhjen politike të krizës së Kosovës të miratuar në takimin e Ministrave të Jashtëm të G-8 të mbajtur në Qendrën Petersberg më 6 maj 1999, thekson:

Një proces politik në drejtim të krijimit të një kornize të marrëveshjes së përkohshme politike që siguron një vetëqeverisje të konsiderueshme për Kosovën, duke marrë parasysh plotësisht marrëveshjet e Rambujesë dhe parimet e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe vendeve të tjera të rajonit, dhe demilitarizimin e UÇK-së.²⁵

Ndërhyrja Ushtarake e NATO-s në Kosovë - Operacioni 'Forca Aleate' 24 mars - 10 qershor 1999

23. Si një mjet i fundit, një ndërhyrje nga Aleanca e NATO-s u zhvillua në mars të vitit 1999, pasi përpjekjet e zgjata diplomatike ndërkombëtare, duke përfshirë edhe

²⁴ Kuptimi i Marrëveshjeve të Rambujesë, Fleta e të dhënave e lëshuar nga Byroja për Çështje Evropiane, Departamenti Amerikan i Shtetit, Washington, DC, mars 1, 1999. Në dispozicion në: https://1997-2001.state.gov/regions/eur/fs_990301_rambouillet.html.

²⁵ Aneksi 1 i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të 10 qershorit 1999 (Deklaratë e Kryetarit për përmbylljen e takimit të Ministrave të Jashtëm të G-8 mbajtur në Qendrën Petersberg më 6 maj 1999).

konferencën e Rambujesë, kishin dështuar. Forcat jugosllave kishin shtyrë më shumë se 400,000 njerëz të largohen nga shtëpitë e tyre, shumë prej të cilave u shkatërruan me granata dhe zjarrvënie. Këshilli i Sigurimit të OKB-së kishte miratuar një rezolutë (1199) duke thirrur Kapitullin VII të Kartës së saj, duke kërkuar një tërheqje të forcave "të përdorura për shtypjen civile" dhe "duke vendosur", "se nëse masat konkrete të kërkuara në këtë rezolutë dhe rezolutën 1160 (1998) nuk duhet të merren në konsideratë për veprimet e mëtejshme dhe masat shtesë për të ruajtur ose rivendosur paqen dhe stabilitetin në rajon. Në Rezolutën 1160 (1998), Këshilli i Sigurimit tashmë theksoi se "dështimi për të bërë progres konstruktiv drejt zgjidhjes paqësore të situatës në Kosovë do të çojë në shqyrtimin e masave shtesë".

24. Fushata brutale e autoriteteve serbe ka vazhduar gjatë gjithë periudhës së veprimeve të NATO-s. Ushtria serbe do të synonte në mënyrë specifike të rinjtë meshkuj. Krimet seksuale kundër grave të të gjitha moshave ishin po ashtu pjesë e fushatës. Më shumë se 800,000 njerëz u dëbuan me forcë ose u larguan nga shtëpitë e tyre nga frika e forcave policore, ushtarake dhe paramilitare serbe. Siç e përshkruan një autor, [vajzat e reja u përdhunuan dhe djemtë u vranë pasi që ata mund të rriteshin për të qenë luftëtarë guerile. "Sipas Urdhrave/Urdhërësive: Krimet e Luftës në Kosovë", një raport i Human Rights Watch thotë, "[vrasjet e qëllimshme dhe të paligjshme të civilëve - ekzekutimet jashtëgjyqësore - ishin një pjesë kyçe e fushatës së 'spastrimit'. Në tërë krahinën, civilët që ishin qartësisht jo luftëtarë, përfshirë gratë dhe disa fëmijë, u vranë nga policia serbe, ushtarët e ushtrisë jugosllave dhe forcat paraushtarake në vrasjet e stilit ekzekutues".

25. Sipas një Komisioni të Ekspertëve të Kombeve të Bashkuara, këto metoda përbënin një politikë të njohur si "spastrimi etnik."²⁶ Përmes një fushate të gjerë dhe sistematike të terrorizmit dhe dhunës, popullata shqiptare e Kosovës detyrohej të

²⁶Raporti i Kosovës: Konflikti: Përgjigja Ndërkombëtare, Mësimet e Mësuara, Komisioni Ndërkombëtar i Pavarur për Kosovën, Oxford University Press, 2000. Në dispozicion në: <https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/6D26FF88119644CFC1256989005CD392-thekosovoreport.pdf>.

zhvendosej me forcë brenda dhe jashtë Kosovës.²⁷ Qëllimi i përbashkët ishte të zhvendosnin një numër të konsiderueshëm, i mjaftueshëm për të ulur balancën demografike më shumë drejt barazisë etnike dhe për t'i detyruar shqiptarët e Kosovës të nënshtrohen.²⁸ Synimi për të reduktuar popullsinë shqiptare në Kosovë në rreth 600,000 duke vrarë anëtarë të grupit ose duke i përzënë me forcë ata, ishin të njohura nga zyrtarët e huaj dhe janë folur publikisht nga zyrtarët serbë.²⁹ Zyrtarët më të lartë serbë, Slobodan Millosheviq, Milan Milutinoviq, Nikola Šainoviq, Dragoljub Ojdanić, Nebojsa Pavkoviq, Vladimir Lazareviq, Sreten Lukiq ishin përgjegjës jo vetëm për miratimin dhe zbatimin e politikave shtypëse kundër shqiptarëve kosovarë, por edhe për krimet që u zhvilluan në Kosovë në vitet 1998-1999.

- 26.** Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në rastet e *Ligjshmërisë së Përdorimit të Forcës* kishte shprehur shqetësim të thellë lidhur me tragjedinë njerëzore që po ndodhte në Kosovë:

[...]Gjykata është thellësisht e shqetësuar me tragjedinë njerëzore, humbjen e jetëve dhe vuajtjet e mëdha në Kosovë, të cilat përbëjnë sfondin e këtij konflikti momental dhe me humbjen e vazhdueshme të jetëve dhe vuajtjeve njerëzore në të gjitha pjesët e Jugosllavisë.³⁰

²⁷ ICTY, *Prosecutor v. Milutinovic et al*, No. IT-05-87, Aktgjykimi i 26 shkurtit 2009, Vol. 3, par. 95, fq. 41.

²⁸ Po aty.

²⁹ Shih, p.sh., Steven Erlanger, 'Serbët duan disa shqiptarë në Kosovë, thonë zyrtarët', *New York Times*, 25 prill 1999, f. 14. Në dispozicion në:

<https://archive.nytimes.com/www.nytimes.com/library/eorld/europe/042599kosovo-belgrade.html>.

³⁰ Rasti lidhur me *Ligjshmërinë e Përdorimit të Forcës (Jugosllavia kundër Belgjikës)*, *Kërkesë për Paraqitjen e Masave të Përkohshme*, ICJ Rep. 1999, fq. 131, para. 16. Shih gjithashtu nëntë raste tjera të *Ligjshmërisë së Përdorimit të Forcës*

Rezoluta 1244 dhe Themelimi i Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

- 27.** Më 10 qershor 1999, Qeveria Serbe pranoi tërheqjen e forcave serbe nga Kosova, duke hapur rrugën për miratimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999). Rezoluta 1244 autorizoi krijimin e një misioni të përkohshëm administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe vendosjen e një force të sigurisë të udhëhequr nga NATO (KFOR). Kështu, Kosova u vendos nën një administratë tranzitore të Kombeve të Bashkuara, në pritje të një zgjidhjeje politike për statusin e saj të ardhshëm politik.
- 28.** Pas shqyrtimit të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të 23 majit 2005, Sekretari i Përgjithshëm e caktoi z. Kai Eide (Norvegji) si të dërguarin e tij të posaçëm për të ndërmarrë një rishikim të plotë të situatës në Kosovë³¹. Zoti Eide ka konkluduar se ka ardhur koha për të kaluar në fazën e ardhshme të procesit politik. Bazuar në vlerësimin e dhënë në raport dhe konsultimet e mëtejshme, Sekretari i Përgjithshëm pranoi përfundimin e z. Eide. Prandaj ai shprehu synimin e tij për të filluar përgatitjet për emërimin e një të dërguari të posaçëm për të udhëhequr procesin e statusit të ardhshëm.
- 29.** Në një deklaratë të 24 tetorit 2005 të bërë nga Presidenti i Këshillit të Sigurimit në emër të Këshillit, Këshilli i Sigurimit u pajtua me vlerësimin e Ambasadorit Eide dhe përshëndeti gatishmërinë e Sekretarit të Përgjithshëm për të emëruar një të dërguar të posaçëm për të udhëhequr procesin e statusit.³²

³¹ OKB Dok. S/2005/335 dhe Corr.1

³² Deklaratë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit, S/PRST/2005/51, 24 tetor 2005.

Procesi i Negocimit të Statusit Final të Mbikëqyrur Ndërkombëtarisht

30. Sekretari i Përgjithshëm emëroi z. Martti Ahtisaari si të dërguarin e tij të posaçëm në nëntor të vitit 2005 për të ndërmarrë procesin e statusit të ardhshëm të parashikuar në Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Mandati i tij duhej të kryhej në përputhje me dhjetë parimet udhëzuese të miratuara nga Grupi i Kontaktit.³³ Në një deklaratë nga Ministrat e Grupit të Kontaktit të datës 31 Janar 2006 u tha se ata prisnin nga Beogradi të kishte parasysh se zgjidhja duhet ndër të tjera të jetë e pranueshme për popullin e Kosovës dhe se politikat katastrofike të së kaluarës shtrihen në zemër të problemeve aktuale.³⁴
31. Pas pesëmbëdhjetë muajsh të negociatave të sponsorizuara nga OKB, z. Ahtisaari përgatiti një Propozim Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, në të cilin ai rekomandoi që statusi i Kosovës të jetë 'pavarësi e mbikëqyrur'. I Dërguari i Posaçëm i raportoi Sekretarit të Përgjithshëm në vitin 2007 (në "Raportin e Ahtisaarit") se, edhe pse ai dhe ekipi i tij "mbajtën negociata intensive me udhëheqësit e Serbisë dhe Kosovës gjatë vitit të kaluar" për të arritur një "zgjidhje politike që përcakton statusin e ardhshëm të Kosovës", "u bë e qartë ... se palët nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje mbi statusin e ardhshëm të Kosovës."³⁵ I Dërguari i Posaçëm raportoi se "[Të dyja palët kanë riafirmuar pozitat e tyre kategorike, e diametralisht të kundërta", duke theksuar më tej se "[Është pikëpamja ime e fortë se potencialet e negociatave për të prodhuar ndonjë rezultat të pranueshëm reciprokisht mbi statusin e Kosovës është i shterur. Asnjë numër i bisedimeve shtesë, pa marrë parasysh formatin, nuk do të mund ta kapërcej këtë bllokim."³⁶ Duke vënë në dukje se "gjendja e limbos (state of limbo) së Kosovës nuk mund të vazhdojë", pasi "paqartësia mbi statusin e saj të ardhshëm është bërë

³³ Parimet udhëzuese të Grupit të Kontaktit për zgjidhjen e statusit të Kosovës të nëntorit 2005. Tre pikat kryesore ishin mos-kthimi i Kosovës në situatën para vitit 1999, asnjë ndarje e Kosovës dhe asnjë bashkim i Kosovës me asnjë pjesë ose me një pjesë të një tjetër vendi. Grupi i Kontaktit përbëhet nga Franca, Gjermania, Italia, Rusia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

³⁴ Deklarata e Grupit të Kontaktit të Kosovës, Londër, 31 janar 2006. Në dispozicion në: https://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms_Data/docs/pressdata/en/declarations/88236.pdf.

³⁵ S/2007/168, para. 1.

³⁶ Po aty., para. 3.

pengesë kryesore për zhvillimin demokratik të Kosovës, llogaridhënie, rimëkëmbjen ekonomike dhe pajtimin ndëretnik”, i dërguari i posaçëm konkludoi se, “ka ardhur koha për të zgjidhur statusin e Kosovës.”³⁷

- 32.** Në përputhje me këtë, ai erdhi në përfundimin për sa vijon: “Pas shqyrtimit të kujdesshëm të historisë së re të Kosovës, realiteteve të Kosovës sot dhe duke marrë parasysh negociatat me palët, unë kam ardhur në përfundimin se i vetmi opsion i mundshëm për Kosovën është pavarësia, për një periudhë fillestare me mbikëqyrje nga bashkësia ndërkombëtare. Propozimi im Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i cili parashtron këto struktura ndërkombëtare mbikëqyrëse, siguron themelet për një Kosovë të ardhshme të pavarur që është e aftë për të pasur sukses, e qëndrueshme dhe stabile dhe në të cilën të gjitha komunitetet dhe anëtarët e tyre mund të jetojnë një ekzistencë paqësore dhe dinjitoze”³⁸
- 33.** Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, duke transmetuar raportin e të Dërguarit të tij Special në Këshillin e Sigurimit, deklaroi se: “Unë mbështes plotësisht të dy rekomandimet e bëra nga i Dërguari im i Posaçëm në raportin e tij mbi statusin e ardhshëm të Kosovës dhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.”
- 34.** Pas një periudhe diskutimi në Këshillin e Sigurimit, Grupi i Kontaktit (Franca, Gjermania, Italia, Rusia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara) propozuan që një “trojkë” (treshe) përfaqësuesish nga BE, Shtetet e Bashkuara dhe Rusia të ndërmarrin një periudhë tjetër negociatash midis Beogradit dhe Prishtinës për statusin e ardhshëm të Kosovës, “çështja e fundit kryesore lidhur me rënien e Jugosllavisë”. Me datë 1 gusht , 2007, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së mirëpriti këtë nismë, duke ripohuar besimin e tij se *status quo*-ja ishte e paqëndrueshme dhe kërkoi që një raport të dorëzohej nga Grupi i Kontaktit për këto përpjekje deri më 10 dhjetor 2007. Edhe pse “dialogu më i drejtpërdrejt, më i qëndrueshëm dhe

³⁷ Po aty., para. 5.

³⁸ Po aty., para. 5.

intensiv i nivelit të lartë që kur përfunduan armiqësitë në Kosovë më 1999”, përfaqësuesit e Trojkës raportuan se “palët nuk u pajtuan të arrijnë një marrëveshje mbi statusin e Kosovës”.

Deklarata e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008

- 35.** Në vitin e nëntë nën administratën kalimtare të udhëhequr nga OKB-ja dhe pas një serie bisedimesh të pasuksesshme të ndërmjetësuara ndërkombëtarisht, të mbledhur në një mbledhje të jashtëzakonshme më 17 shkurt 2008, përfaqësuesit e zgjedhur në mënyrë demokratike të popullit të Kosovës e shpallën Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, duke vënë në dukje se ky akt “pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në përputhje të plotë me rekomandimet e të dërguarit të posaçëm të OKB-së Marti Ahtisaari dhe Propozimit të tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.³⁹”
- 36.** Një opinion këshillues është kërkuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së për çështjen e ligjshmërisë së Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës.⁴⁰ Gjykata dha mendimin e saj këshillues më 22 korrik 2010. Në Opinionin e saj këshillëdhënës të 22 korrikut, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka konkluduar se miratimi i shpalljes së pavarësisë së 17 shkurtit 2008 nuk ka shkelur të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) ose Kornizën Kushtetuese.⁴¹ Rrjedhimisht, miratimi i kësaj deklarate nuk ka shkelur asnjë rregull të aplikueshëm të së drejtës ndërkombëtare.⁴²

³⁹ Shih *ndër të tjera* Pavarësia e Kosovës. Në dispozicion në: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Dek_Pav_e.pdf. Paragrafi i plotë: “We, the democratically-elected leaders of our people, hereby declare Kosovo to be an independent and sovereign state. This declaration reflects the will of our people and it is in full accordance with the recommendations of UN Special Envoy Martti Ahtisaari and his Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement.”

⁴⁰ Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, *në pajtim me Deklaratën e njëanshme të Pavarësisë së Kosovës në Opinionin e Kosovës, Opinioni Këshillëdhënës* i 22 Korrikut 2010.

⁴¹ Po aty., para. 122.

⁴² Po aty.

II. Koncepti i Reparacioneve (dëmshpërblimit) në të Drejtën Ndërkombëtare

Parimet përmbajtësore për reparacionet sipas të drejtës ndërkombëtare

37. Parimi në të drejtën ndërkombëtare që afirmon detyrimin për të siguruar dëmshpërblim daton shumë vite më herët. Tashmë në vitin 1927 dhe 1928, Gjykata e Përhershme e Drejtësisë Ndërkombëtare (GJPDN), paraardhësja e GJND-së së sotme, kishte deklaruar në rastin e njohur si *Fabrika në Chorzow* se:

Është një parim i së drejtës ndërkombëtare dhe madje një konceptim i përgjithshëm i ligjit se çdo shkelje e ndonjë angazhimi përfshinë një obligim për ta bërë reparacionin në një formë adekuate ... dëmshpërblimi është një plotësues i patjetërsueshëm i dështimit për të zbatuar një konventë dhe për këtë nuk është e nevojshme që të theksohet në vetë konventën.⁴³

Reparacioni duhet, sa të jetë e mundur, të fshijë të gjitha pasojat e aktit të paligjshëm dhe të rivendosë situatën që me gjasë do të ekzistonte nëse ky akt nuk do të ishte kryer. Kthimi i plotë, ose, nëse ky nuk është i mundur, duhet të paguhet një shumë që korrespondon me vlerën që kthimi në fjalë do ta mbante ... të tilla janë parimet të cilat duhet të shërbejnë për të përcaktuar shumën e dëmshpërblimit për një veprim në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.⁴⁴

38. Shprehja e vendosur në fjalinë hyrëse të GJPDN-së në rastin e *Fabrikës në Chorzow* është përmendur gjerësisht dhe riafirmohet në një numër të aktgjykimeve të GJND-

⁴³ *Fabrika në rastin Chorzow* (Gjermania kundër Polonisë), Jurisdiksioni, 1927, PCIJ, Ser. A, Nr. 9, fq. 21.

⁴⁴ *Fabrika në rastin Chorzow* (Gjermania kundër Polonisë), Meritat, 1928, PCIJ, Ser. A, Nr. 17, f. 47

së, duke përfshirë rastin e *Projektit Gabcikovo-Nagymaros*,⁴⁵ rastin më të fundit lidhur me *aktivitetet e armatosura në territorin e Kongos*⁴⁶ dhe në një numër rastesh të tjera në praktikën e institucioneve gjyqësore ndërkombëtare dhe rajonale.⁴⁷

39. Siç mund të vërehet më lart, rasti *Fabrika në Chorzow* merret vetëm me dy forma të reparacioneve: domethënë kthimin dhe kompensimin. Këto komponentë historikisht përbënin themelet kryesore për konceptin e reparacioneve, të cilat në anën tjetër janë shtuar për shkak të interpretimeve në jurisprudencën e të drejtave të njeriut në veçanti. Në rastet e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, është qartësisht e pamundur të arrihet *resitutio in integrum*, domethënë të rivendoset gjendja që ekzistonte para akteve të gabuara. Për shembull, siç është thënë nga Christian Tomuschat, “të vdekurit nuk mund të kthehen në jetë”⁴⁸; kështu, kjo formë dëmshpërblimi mund të mos jetë e zbatueshme në një seri rrethanash të jetës reale.
40. Historikisht, në përgjithësi, e drejta ndërkombëtare e shihte reparacionin si masë ndër-shtetërore. Megjithatë, konvergjenca e një numri zhvillimesh në të drejtën ndërkombëtare gjatë dekadave të fundit ka prodhuar ndryshime të rëndësishme që janë njohur në të drejtën ndërkombëtare të përgjithshme. Disa prej tyre përfshijnë: afirmimin e përgjegjësisë shtetërore në lidhje me disa të drejta themelore të njeriut nëpërmjet avancimit të dispozitave të traktateve të shumta në ligjin humanitar si dhe të të drejtave të njeriut. Disa prej tyre kanë fituar njohje si ligj zakonor dhe, në disa raste, madje edhe si norma përvetësuese të së drejtës ndërkombëtare që komuniteti botëror ka një interes të përbashkët për të mbrojtur. Nenet e ILC-së (*International Law Commission / Komisioni për të Drejtën Ndërkombëtare*) mbi përgjegjësinë e shtetit të miratuara në vitin 2001 mbështesin këtë pohim. Nenet përcaktojnë dëmshpërblimin si të përbërë nga komponentët e mëposhtëm:

⁴⁵ *Rasti i Projektit Gabcikovo-Nagymaros* (Hungaria kundër Sllovakisë), Raporti i ICJ 1997, f. 7, paragrafët 149-52.

⁴⁶ *Aktivitetet e Armatosura në Territorin e Kongos* (Republika Demokratike e Kongos kundër Ugandës), Raporti i ICJ 2005, f. 82, par. 259.

⁴⁷ Shembujt përfshijnë *Papamichalopoulos kundër Greqisë* (neni 50), ECtHr, Ser. A, Nr. 330-B, 1995, para. 36; Velasquez Rodriguez, IACtHR, Ser. C, Nr. 4, 1989, f. 26-7, 30-1.

⁴⁸ Christian Tomuschat, *Reparacioni në Rastet e Gjenocidit*, *Journal of International Criminal Justice*, 5(4) 2007, pp. 905-912.

garancitë e mos përsëritjes (Neni 30); kthimi (Neni 34); kompensimi (neni 36); dhe përmbushja (kënaqësia)(Neni 37). Ndonëse të drejtat e njeriut nuk referohen në mënyrë specifike në Nenet e ILC-së, komentet zyrtare të Nenit 33 pohojnë se:

Kur ekziston një detyrim për reparacion ndaj një shteti, reparacioni nuk rritet domosdoshmërisht për përfitimin e atij shteti. Për shembull, përgjegjësia e shtetit për shkeljen e një detyrimi sipas një traktati në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut mund të ekzistojë ndaj të gjitha palëve të tjera të traktatit, por individët në fjalë duhet të konsiderohen si përfituesit përfundimtarë dhe në këtë kuptim si mbajtësit e të drejtave përkatëse.⁴⁹

41. Afirmimi shtesë i pranimit të së drejtës së individëve për dëmshpërblime në të drejtën ndërkombëtare të përgjithshme mund të gjendet në Opinionin Këshillëdhënës të GJND-së mbi *Pasojat Ligjore të Ndërtimit të një Muri në Territorin e Pushtuar Palestinez* më 2004⁵⁰, i cili afirmoi detyrën e Izraelit që të sigurojë kthimin dhe kompensimin e individëve si dhe “të gjithë personave fizik dhe juridik që kanë pësuar ndonjë formë dëmi material si rezultat i ndërtimit të murit”.
42. Siç tregohet në këtë mënyrë, parimi bazë mbi reparacionin sipas të drejtës ndërkombëtare është formuluar nga Gjykata e Përhershme e Drejtësisë Ndërkombëtare në rastin që ka të bëjë me *Fabrikën në Chorzow*: “dëmshpërblimi duhet, sa të jetë e mundur, të fshijë të gjitha pasojat e veprimeve të paligjshme dhe rivendosjen e situatës që me gjasë do të ekzistonte nëse ky akt nuk do të ishte kryer”.⁵¹ Kjo deklaratë i referohet parimit të dëmshpërblimit si *restitutio in integrum*. Ky koncept është interpretuar në mënyra të ndryshme nga tribunalet ndërkombëtare dhe organet e tjera, të cilat përcaktojnë format dhe shkallën e

⁴⁹ ILC, Komentaret mbi Draft-Nenet mbi Përgjegjësinë e Shteteve për Veprat e Gabuara Ndërkombëtare, Neni 33, para. 3 [në tekstin e mëtutjeshëm "Komentarë"].

⁵⁰ *Pasojat ligjore të ndërtimit të një muri në territorin e pushtuar palestinez*, Opinioni Këshillëdhënës, 9 korrik 2004, Raporti i ICJ, paragrafët 145, 152-3

⁵¹ *Rasti në lidhje me Fabrikën në Chorzow* (merits) PCIJ, Series A, Nr. 17, 1928, f. 47.

reparacioneve që mund të jepen. Nën përgjegjësinë tradicionale të Shtetit, një pikëpamje paguese e reparacioneve tenton të mbizotërojë, me theks të veçantë në masa të tilla si kthimi dhe kompensimi për të siguruar dëmshpërblim.

43. Në bazë të parimit të proporcionalitetit, reparacioni duhet të jetë proporcional me dëmin e shkaktuar nga veprimi i gabuar,⁵² termi “dëmtim” që përfshinë dëmet materiale dhe morale. Në këtë drejtim, duhet theksuar se përderisa dëmi do të jetë i rëndësishëm për formën dhe sasinë e reparacionit, ekzistenca e dëmit material nuk përkthehet në një detyrim për të kërkuar dëmshpërblim.⁵³
44. Një pasojë e rëndësishme e parimit të proporcionalitetit është se reparacionet nuk janë ndëshkuese në natyrë. Kjo është kështu pa marrë parasysh rëndësinë e shkeljes.⁵⁴ Reparacionet duhet ekskluzivisht të synojnë rregullimin e dëmit të kryer nga aktet e gabuara, dhe jo të konceptohen si masë e jashtëzakonshme.
45. Lidhur ngushtë me parimin e proporcionalitetit dhe natyrën e lidhjes midis aktit të paligjshëm dhe dëmit të pësuar, parimi i shkakësisë tregon që dëmshpërblimet duhet të korrigjojnë vetëm dëmet e drejtpërdrejta të prodhuara nga veprimi i paligjshëm, duke lënë jashtë ato dëmtime të cilat janë shumë indirekte apo të largëta. Sidoqoftë, ish-Raportuesi Special i Komisionit Ndërkombëtar të Drejtësisë për Përgjegjësinë e Shtetit, James Crawford, vendosi që elemente të tjera të shkeljes, siç është sjellja e pahijshme e organeve shtetërore, duhet të merren parasysh, sepse "... kërkesa e një lidhjeje shkakësore nuk është domosdoshmërisht e njëjtë në lidhje me çdo shkelje të një detyrimi ndërkombëtar."⁵⁵
46. Ekziston një rregull vartës i parimit të shkakësisë, i cili është i rëndësishëm në rastet kur dëmi është pasojë e shkaqeve të njëkohshme dhe nuk është e mundur të atribuohen të gjitha dëmtimet tek një shkak apo subjekt. Për shembull, në rastin e

⁵² Draft Nenet, art. 31.

⁵³ Komentarët, art. 31, paras. 5 and 7.

⁵⁴ Po aty., kapitulli III, para. 5.

⁵⁵ Po aty., art. 31, para. 10.

Kanalit të Korfuzit (Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut kundër Shqipërisë),⁵⁶ në të cilën Shqipëria nuk i paralajmëroi anijet britanike për ekzistencën e minave në detin e saj, të vendosura nga shtete të tjera, si rrjedhim Shqipëria u urdhërua të pajtohej me të gjitha masat e reparacionit dhënë Mbretërisë së Bashkuar. Kështu, e drejta ndërkombëtare ka përcaktuar që nëse një pjesë e dëmtimit mund të jetë e shkëputur në kushtet e rastësishme nga ajo që i atribuohet subjektit përgjegjës, ky i fundit është përgjegjës për të gjitha pasojat jo shumë të largëta të sjelljes së gabuar të kryer.⁵⁷

47. E drejta ndërkombëtare ka përcaktuar gjithashtu disa forma të reparacionit të cilat vetë ose në kombinim, synojnë të ofrojnë reparacion të plotë për dëmin e shkaktuar. Duke ndjekur parimin e *restitutio in integrum* siç thuhet nga GJPDN, i pari nga këto forma është **rikthimi**. Ai synon të vendosë gjërat ashtu siç ishin para se të ndodhte akti i gabuar. Kthimi është forma e preferuar e reparacionit sipas të drejtës ndërkombëtare, por në shumë situata nuk është e mundur duke pasur parasysh natyrën e shkeljes ose sepse është e pamjaftueshme në sigurimin e dëmshpërblimit adekuat për dëmin e pësuar.
48. Në rastin që ka të bëjë me *Fabrikën në Chorzow*, GJPDN ka deklaruar se kur kthimi nuk është i mundur, duhet të paguhet një shumë që korrespondon me vlerën që kthimi në fjalë do ta mbante.⁵⁸ Kjo formë reparacioni zakonisht njihet si **kompensim** dhe urdhërohet kur ka dëmtime që nuk mund të korrigjohen vetëm me kthimin. Siç është thënë nga Crawford, "...shpërblimet e kompensimit përfshijnë humbjet materiale (humbja e të ardhurave, pensionet, shpenzimet mjekësore, etj.) dhe dëmet jo materiale (dhimbjet dhe vuajtje, ankth mendor, poshtërim, humbje të gëzimit të jetës dhe humbje e shoqërimit ose shoqërisë), kjo e fundit zakonisht kuantifikohet në bazë të një vlerësimi të drejtë...".⁵⁹

⁵⁶ *Rasti i Korfuzit*, Aktgjykimi i 9 prillit: Raportet e ICJ 1949, f. 4.

⁵⁷ Komentaret, art. 31, paras. 12-13.

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ Ibid, art. 36, para. 19.

49. Së fundi, **satisfaksioni** (kënaqësia) është një formë tjetër e reparacionit e njohur nga e drejta ndërkombëtare. Në gjykimin ndërshtetëror ajo ka një karakter mjaft të jashtëzakonshëm, pasi ajo shfaqet vetëm kur kthimi dhe kompensimi nuk arrijnë kompensim të plotë,⁶⁰ dhe i referohet dëmtimeve që nuk janë financiarisht të vlerësueshme, dhe të cilat përbëjnë fyerje ndaj shtetit.⁶¹ Për më tepër, megjithëse masat e kënaqshmërisë sipas së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare zakonisht marrin formën e qëndrimeve deklarative në lidhje me sjelljen e padrejtë dhe të gabuar,⁶² masa të forta si për shembull kërkim faljet zyrtare ose ndërtimi i përmendoreve, nuk mund të hidhen poshtë. Në të vërtetë, projektligjet i referohen "shkeljeve serioze të detyrimeve sipas normave të drejta të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare",⁶³ dhe ata supozojnë që shkeljet e tilla shkaktojnë dëme të rënda jo-materiale që kërkojnë forma të tjera të dëmshpërblimit, si kërkim faljet formale.

Parimet e Reparacionit sipas së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare

50. Referencat për dëmshpërblimet në të drejtën humanitare ndërkombëtare mund të gjurmohen në Nenin 3 të Konventës IV të Hagës të vitit 1907, formulim i cili përsëritet në Nenin 91 të Protokollit Shtesë I të Konventave të Gjenevës të 1949.⁶⁴Thëkson se:

Një Palë në konflikt që shkel dispozitat e Konventave ose të këtij Protokollit, nëse kërkohet nga rasti, do të jetë përgjegjëse për të paguar kompensimin. Ajo do të jetë përgjegjëse për të gjitha veprimet e kryera nga personat që janë pjesë e forcave të saj të armatosura.

⁶⁰ Ibid, art. 37, para. 1.

⁶¹ Ibid, art. 37, para. 3.

⁶² Ibid, art. 37 para. 6.

⁶³ Draft Nenet, art. 41.3; and Commentaries, art. 41, paras. 13-14.

⁶⁴ E-C. Gillard, Reparation for Violations of International Humanitarian Law, *International Review of the Red Cross*, 85(851) (2003), 529–53

51. Komentari zyrtar i ICRC-së⁶⁵ (Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq) jep disa udhëzime të mëtejme mbi interpretimin e disa dispozitave. Në përputhje me të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, Neni është ndërtuar në supozimin se ai do të ushtrohet nëpërmjet një mekanizmi ndërshtetëror. Komenti i ICRC, megjithatë, jep pak udhëzime se si shtetet duhet të sigurojnë që palët jo-shtetërore në një konflikt të përmbushin detyrimin për të paguar kompensimin. Duke marrë parasysh shkallën e tanishme të konflikteve të brendshme të armatosura që përfshijnë njësitë jo-shtetërore, kjo ilustron një hendek të madh në të drejtën ndërkombëtare humanitare.
52. Është e rëndësishme të observohet se komentari pohon që përgjegjësia e shtetit mund të shkaktohet edhe nga mosveprimi kur nuk është demonstruar kujdesi i duhur për të parandaluar shkeljet, dhe në momentin që ato kanë ndodhur, represioni i atyre akteve nuk është siguruar.⁶⁶ Për më tepër, neni 91 i referohet specifikisht mbulimit të të gjitha dispozitave të Konventave të Gjenevës. Komentari shpjegon se termi kompensim, përgjithësisht i perceptuar si referencë ndaj dëmshpërblimit monetar, në këtë kontekst përfshin detyrimin për të siguruar rikthimin sa më shumë që të jetë e mundur, përveç kompensimit financiar.
53. Ndërsa një interpretim konservativ i nenit 91 nuk e njeh atë si një burim të të drejtave në favor të individëve,⁶⁷ shkollarë të ndryshëm, përfshirë Kalshoven dhe Greenwood, kanë dhënë kontribute të vlefshme për ta zgjeruar interpretimin e Nenit 91. Ata i kanë mbështetur argumentet e tyre mbi *travaux preparatoires* së Konventës IV të Hagës së vitit 1907, e cila tregon se dispozita nuk kishte për qëllim të kufizohej në pretendimet midis shteteve, por duhej të konceptohej si krijimi i një

⁶⁵ Protokollin shtesë I në Konventat e Gjenevës, ICRC Komentari i nenit 91, paragrafi 3645-61.

⁶⁶ Protokollin shtesë I në Konventat e Gjenevës, ICRC Komentari i nenit 91, paragrafi. 3660.

⁶⁷ Provost, të Drejtat Ndërkombëtare të Njeriut dhe të Drejtës Humanitare, f. 47-56. Megjithatë, Provost bën të ditur se ndërsa shprehin rezerva lidhur me të drejtën e dëmshpërblimit në të drejtën humanitare, disa shkelje të tilla janë "të ndërlydhura me shkeljet e të drejtave të pa derogueshme të njeriut, për të cilat kanë padyshim të drejtën për një ilaç dhe se komplementariteti i të drejtave të njeriut dhe ligji humanitar siguron që viktimat të mos mbeten pa të drejtë për reparacion për lëndimet e tyre ", f. 49. Shih gjithashtu C. Tomuschat, 'Reparation for Victims of Grave Human Rights Violations', Tulane Journal of International and Comparative Law, 10 (2002), f. 178-9.

të drejte të drejtpërdrejt për kompensim për individët.⁶⁸ Debati mbi ri-interpretimin e nenit 91 rrjedh pjesërisht nga lëvizja korrektuese kundër qeverisë japoneze në vitet 1990, gjatë së cilës të dy studiuesit paraqitën këshilla ligjore për të drejtën e reparacionit.⁶⁹ Për më tepër, është vërejtur se krijimi i Komisionit të Kompensimit të Kombeve të Bashkuara (UNCC) nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në vitin 1991, pas luftës në Irak, demonstroi përgjegjësinë e shtetit në lidhje me reparacionet për shkeljet e të drejtës humanitare.⁷⁰

54. Me rëndësi të konsiderueshme është fakti se ICRC në mënyrë të veçantë ka pohuar, në studimin e thelluar të vitit 2005 të së drejtës ndërkombëtare humanitare zakonore, se përgjegjësia shtetërore për reparacione është vendosur si një normë zakonore si në konfliktet e armatosura ndërkombëtare ashtu dhe në ato jo-ndërkombëtare.⁷¹

Parimet e Reparacionit sipas të Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut

55. Në kundërshtim me ligjin humanitar, dispozitat për mjetet juridike dhe dëmshpërblimet janë elemente kyçe në të gjitha instrumentet e të drejtave të njeriut, të cilat krijojnë një mori mekanizmesh të detyrueshme, ligjërish obligative dhe kuazi-gjyqësore. Jurisprudenca e të drejtave të njeriut ka luajtur një rol të rëndësishëm në përcaktimin e formave të ndryshme të reparacioneve dhe ka dhënë

⁶⁸ Greenwood, 'International Humanitarian Law', f. 250; F. Kalshoven, 'State Responsibility for Warlike Acts of the Armed Forces', *International and Comparative Law Quarterly*, 40 (1991), 827, 830. Ky argument gjithashtu mbështetet nga L. Zegveld, 'Remedies for Victims of Violations of International Humanitarian Law', f. 497-526; Gillard, 'Reparation for Violations of International Humanitarian Law', pp. 529-53 and R. Pisillo Mazzeschi, 'Reparation Claims by Individuals for State Breaches of Humanitarian Law and Human Rights: An Overview', *Journal of International Criminal Justice*, 1 (2003), 339-47.

⁶⁹ S. Hae Bong, 'Compensation for Victims of Wartime Atrocities, Recent Developments in Japan's Case Law', *Journal of International Criminal Justice*, 3(2005), 189.

⁷⁰ A. Gattini, 'The UN Compensation Commission: Old Rules New Procedures on War Reparations', *European Journal of International Law*, 13(1) (2002), 161-81.

⁷¹ Henckaerts and Doswald-Beck, *Customary International Humanitarian Law*, Rule 150: 'A State responsible for violations of international humanitarian law is required to make full reparation for the loss or injury caused.'

udhëzime të konsiderueshme në zhvillimin e formave jo-monetare të mjeteve juridike.

56. Origjina e dëmshpërblimeve në ligjin për të drejtat e njeriut rrjedh nga miratimi i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR) në vitin 1948, pasi Neni 8 thotë që:

Gjithkush ka të drejtën për një zgjidhje efektive nga gjykatat kompetente kombëtare për veprimet që shkelin të drejtat themelore që i janë garantuar nga kushtetuta ose me ligj.

57. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) i bën jehonë dispozitës së mësipërme si një normë ligjërishit detyruese në Nenin 2 (3a): “çdo person, të drejtat apo liritë e të cilit në këtë rast janë shkelur duhet të kenë një mjet efektiv”. Nenet 9 (5) dhe 14 (6) parashikojnë të drejtën e kompensimit për arrestim, ndalim dhe dënim të paligjshëm. Komiteti i të Drejtave të Njeriut ka dhënë interpretim të konsiderueshëm të përmbajtjes së konceptit “mjet juridik efektiv” në vendimet e tij në rastet e peticioneve individuale, komentet e përgjithshme mbi interpretimin e dispozitave të traktatit dhe gjithashtu në vëzhgimet përmbyllëse të raporteve të palëve shtetërore.

58. Në vitin 2004, Komiteti i të Drejtave të Njeriut ka miratuar Komentin e tij të Përgjithshëm nr. 31 mbi Natyrën e Detyrimeve të Përgjithshme Ligjore të vendosura mbi shtetet palë të paktit, kryesisht i frymëzuar nga miratimi i projektligjeve të ILC-së mbi përgjegjësinë shtetërore në vitin 2001, dhe pastaj të draftit të parimeve themelore për të drejtën e reparacionit për viktimat. Komenti i Përgjithshëm bën lidhjen mes termave “korrigjim” dhe “dëmshpërblim” duke e deklaruar këtë:

Neni 2, paragrafi 3, kërkon që Shtetet Palë të kryejnë reparacionin për individët, të drejtat e të cilëve janë shkelur. Pa dëmshpërblim për individët, të drejtat e të cilëve janë shkelur, detyrimi për të siguruar një mjet efektiv, i

cili është thelbësor për efikasitetin e nenit 2, paragrafi 3, nuk shkarkohet. Komiteti thekson se, aty ku është e përshtatshme, reparacioni mund të përfshijë kthimin, rehabilitimin dhe masat e satisfaksionit, si për shembull faljet publike, përkujtimet publike, garancitë e mos përsëritjes dhe ndryshimet në ligjet dhe praktikat përkatëse, si dhe sjelljen para drejtësisë së autorëve të shkeljeve të të drejtave të njeriut.⁷²

59. Dispozitat e tjera të traktatit për të drejtat e njeriut, siç është neni 14 i Konventës kundër Torturës (CAT),⁷³ Neni 6 i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (CERD), Neni 39 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës (CRC) dhe Neni 24 (4) i Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyrueshme (CPPED),⁷⁴ e afirmojnë të drejtën e reparacionit në forma të ndryshme. CPPED ofron një kontribut veçanërisht të rëndësishëm pasi hyrja e tij në fuqi në vitin 2010 siguroi një përkufizim të plotë të reparacioneve në një instrument ligjërish detyrues. Neni 24 (4), (5) përcaktoi si në vijim:

Secili shtet palë do të sigurojë në sistemin e tij ligjor që viktimat e zhdukjes me forcë kanë të drejtë të marrin dëmshpërblim dhe kompensim të shpejtë, të drejtë dhe adekuat. E drejta për të marrë dëmshpërblim ... mbulon dëmet materiale dhe morale dhe, kur është e përshtatshme, forma të tjera të dëmshpërblimit, si: (a) kthimi, (b) rehabilitimi, (c) satisfaksioni, përfshirë rivendosjen e dinjitetit dhe të reputacionit; (d) garancitë e mos përsëritjes.

⁷² Komenti i Përgjithshëm i CCPR-së nr. 31, Natyra e Detyrimeve të Përgjithshme Ligjore të Shteteve Palë të Konventës, CCPR / C / 21 / Rev.1 / Add.13, 2004, para. 16.

⁷³ Konventa kundër Torturës dhe Trajtitit ose Ndëshkimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar, Neni 14: "Secili shtet palë do të sigurojë në sistemin e tij ligjor që viktimat e një akti torture të marrë reparacion dhe të ketë të drejtë të detyrueshme për kompensim të drejtë dhe adekuat, duke përfshirë mënyrat për rehabilitim sa më të plotë të jetë e mundur. Në rastin e vdekjes së viktimës si rezultat i një torture, personat e afërt me të do të kenë të drejtën e kompensimit."

⁷⁴ Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Zbatuar, Neni 24 (4): "Secili shtet palë do të sigurojë në sistemin e tij ligjor që viktimat e zhdukjes me forcë kanë të drejtë të marrin dëmshpërblim dhe kompensim të shpejtë, të drejtë dhe adekuat".

60. Pavarësisht të sipër përmendurave, shumë instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë të heshtura lidhur me parimet që duhet të zbatohen për dëmshpërblimet. Kjo ka lejuar organe të ndryshme të të drejtave të njeriut që të zhvillojnë vetë parimet e tyre. Nga të gjitha përvojat e mundshme, ajo e hartuar nga Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtutjeshëm "IACtHR") meriton vëmendje të veçantë. Kjo Gjykatë ka jurisprudencën më të gjerë për reparacionet sipas ligjit ndërkombëtar.
61. Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut gjithashtu ka bazuar dhënien e reparacioneve për të njëjtin parim të *restitutio in integrum* siç është paraqitur tashmë dhe siç thuhet në rastin që ka të bëjë me Fabrikën në Chorzow. Megjithatë, organet e të drejtave të njeriut si IACtHR kanë ri-interpretuar formulën e së drejtës ndërkombëtare në mënyrë që të përfshijë "rivendosjen e gjendjes së mëparshme, dëmshpërblimin e pasojave të shkeljes dhe dëmshpërblimin për dëmet trashëgimore dhe jo-trashëgimore, duke përfshirë dëmin emocional."⁷⁵
62. Parimi i proporcionalitetit është zbatuar edhe në ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, edhe kur merret me shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.⁷⁶ Në këtë drejtim, Parimet dhe Udhëzimet Themelore të OKB-së mbi të drejtën për kompensimin dhe dëmshpërblimin e viktimave të shkeljeve të rënda të Ligjit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe Shkeljet e Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare (në tekstin e mëtejme "Parimet themelore të OKB-së") theksojnë se reparacioni duhet të jetë proporcional me rëndësinë e shkeljeve dhe dëmin e pësuar.⁷⁷ Një pasojë e parimit të proporcionalitetit në fushën e të drejtave ndërkombëtare të njeriut është se masat e reparacionit nuk duhet as të pasurojnë as

⁷⁵ IACtHR, *Velásquez Rodríguez kundër Hondurasit*, Meritat, Aktgjykimi i 29 korrikut 1988, Seria C nr. 4, para. 26.

⁷⁶ Po aty., para. 38.

⁷⁷ Parimet themelore të OKB-së, parimi 15.

të varfërojnë viktimën e shkeljes së të drejtave të njeriut, pasi ato synojnë të eliminojnë efektet e shkeljeve që janë kryer.⁷⁸

- 63.** Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut ka miratuar gjithashtu parimin e shkakësisë, duke theksuar se dëmshpërblimi kërkon ekzistencën e një lidhjeje shkakësore ndërmjet shkeljes së gjetur, dëmit të prodhuar dhe dëmeve të kërkuara.⁷⁹ Kështu, duke i dhënë efekt të plotë parimit të shkakësisë, IACtHR ka zhvilluar koncepte të tilla si “plani i jetës”, i cili “... është (...) i afërt me konceptin e përmbushjes personale, e cila në anën tjetër bazohet në opsionet që një individ mund të ketë për të udhëhequr jetën e tij dhe për të arritur qëllimin që ai ia vendos vetes(...). Këto opsione, në vetvete, kanë një vlerë të veçantë ekzistenciale. Prandaj, eliminimi ose kufizimi i tyre objektivisht e zvogëlon lirinë dhe përbën humbjen e një asemi të vlefshëm, një humbje që kjo Gjykatë nuk mund të shpërfillë”.⁸⁰
- 64.** Parimi i njohjes së duhur të viktimave luan një rol shumë të rëndësishëm në dëmshpërblimet e dhëna nga ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Vlen të kujtojmë se në ligjin ndërkombëtar nocioni i dëmit ka jo vetëm përmasat materiale, por edhe morale.⁸¹ Në ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, kjo është përkthyer në njohjen që shkeljet janë në gjendje të shkaktojnë edhe dëme mentale dhe vuajtje,⁸² gjë që ka lejuar organet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të marrin në konsideratë të afërmit e viktimave direkte të shkeljeve të të drejtave të njeriut, personave të varur dhe personave të cilët kanë pësuar dëm në ndërhyrjen për t’i ndihmuar ata ose për të parandaluar viktimizimin si viktimë në të drejtën e tyre.⁸³

⁷⁸ IACtHR “*Fëmijët e Rrugës*”(Villagrán-Morales et al.) *Kundër Guatemalës, Reparacionet dhe shpenzimet, Aktgjykimi i 26 majit 2001, Seria C Nr. 77, paragrafi. 63.*

⁷⁹ IACtHR, *Ticona Estrada dhe të tjerët kundër Bolivisë, meritat, reparacionet dhe shpenzimet, Aktgjykimi i 27 nëntorit 2008, Seria C nr. 191, par. 110.*

⁸⁰ IACtHR *Loayza-Tamayo kundër Perusë, Reparacionet dhe shpenzimet, Aktgjykimi i 27 nëntorit 1998, Seria C nr. 42, par. 147-148.*

⁸¹ Komentaret, art. 31, para. 5.

⁸² Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Fuqisë, Rezoluta 40/34 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, nëntor 1985, parimi 1.

⁸³ Po aty., parimi 2.

65. Në lidhje me parimin e mësipërm dhe me parimet procedurale të reparacionit, është e mundur të nxjerrim një përfundim nga praktika e organeve të të drejtave të njeriut se ekziston një parim i nënkuptuar që zbaton një qasje fleksibile ndaj standardeve dhe barrës së provës në kërkesat e reparacioneve. Siç thotë Komiteti i të Drejtave të Njeriut, “... barra nuk mund të bie vetëm tek autori i komunikimit, veçanërisht duke pasur parasysh se autori dhe Shteti Palë nuk kanë gjithmonë qasje të barabartë në dëshmi dhe se shpesh vetëm pala shtetërore ka qasje për informacionin përkatës ...”⁸⁴ Pra, për të balancuar këtë situatë në përputhje me aftësinë e viktimës për të vërtetuar dëmin e pësuar, organet ndërkombëtare të gjyqimit janë mbështetur në supozime dhe prova rrethore “kur ato çojnë në konkluzione të qëndrueshme në lidhje me faktet e rastit.”⁸⁵
66. Në varësi të njohjes së duhur të viktimës, është parimi procedural i pjesëmarrjes efektive të viktimave. Parimi 6a) i Deklaratës së Drejtësisë për Viktimat përcakton që viktimat duhet të informohen për rolin e tyre, për shtrirjen, kohëzgjatjen dhe ecurinë e procedurave dhe për natyrën e rasteve të tyre, veçanërisht kur përfshihen krime të rënda dhe ku kanë kërkuar informata të tilla. Për shembull, duhet të theksohet se për herë të parë viktimat u siguruan me *locus standi* para se IACtHR të ishte në fazën e dëmshpërblimit, duke pasur parasysh rëndësinë e rolit të tyre në këtë pjesë të procedurave gjyqësore.⁸⁶
67. Gjithashtu i lidhur me parimet e njohjes së duhur të viktimës dhe pjesëmarrjes efektive, është parimi i marrjes parasysh të situatës së viktimave në çdo rast të caktuar. Në këtë aspekt, parimi 10 i Parimeve Themelore të OKB-së thekson se

⁸⁴ Elena Beatriz Vasilskis kundër Uruguait, Komunikimi nr. 80/1980, U. N. Doc. CCPR / C / OP / 2 në 105 (1990), sesioni i 18-të, para. 10.4.

⁸⁵ IACtHR, *Gangaram Panday kundër Surinamit*, Meritat, reparacionet dhe shpenzimet, Aktgjykimi i 21 janarit 1994, Seria C nr. 16, par. 49.

⁸⁶ Shih Clara Sandoval, “The Concepts of ‘Injured Party’ and ‘Victim’ of Gross Human Rights Violations in the Jurisprudence of the Inter-American Court of Human Rights: A Commentary on their Implications for Reparations” in C. Ferstman, A. Stephens, and M. Goetz (eds.), *Reparations for Victims of Genocide, Crimes against Humanity and War Crimes: Systems in Place and Systems in the Making* (The Netherlands, Brill, 2009), pp. 243-282.

viktimat duhet të trajtohen me njerëzi dhe respekt për dinjitetin e tyre dhe të drejtat e njeriut, dhe kërkon miratimin e masave të duhura për të garantuar sigurinë e tyre, mirëqenien fizike dhe psikologjike dhe privatësinë, si dhe ato të familjeve të tyre.

- 68.** Parimi i mosdiskriminimit në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut bazohet në një të drejtë e cila njihet në pothuajse të gjitha instrumentet e të drejtave të njeriut dhe lidhet me të gjitha aktet e shtetit që prekin njerëzit nën juridiksionin e saj. Prandaj, kur ofrohet korrigjimi për shkeljet e të drejtave të njeriut, shtetet duhet të zbatojnë masat e reparacionit pa diskriminim në asnjë nga bazat të njohura nga e drejta ndërkombëtare.
- 69.** Sa i përket formave të reparacionit të kërkuar për arritjen e dëmshpërblimit të plotë, ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut ka ofruar një sërë masash, të cilat të kombinuara, kërkojnë të sigurojnë kompensim të plotë për dëmin e shkaktuar. Organet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ndjekin atë që ligji ndërkombëtar ka vendosur në këtë drejtim, megjithëse ato kanë hartuar forma të reja të dëmshpërblimit. Kjo qasje gjithëpërfshirëse ka çuar gjithashtu në njohjen se reparacionet mund të jenë individuale dhe kolektive.⁸⁷
- 70.** Për shembull, sa i përket kompensimit, ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut ka aplikuar një parim të barazisë në mënyrë që të llogarisë dëmet materiale dhe jo-materiale, kur këto dëmtime nuk janë vërtetuar plotësisht. Prandaj, kur nuk mund të bëhet llogaritja e humbjes së të ardhurave për shkak se nuk ka bazë për të përcaktuar të ardhurat që viktima do t'i kishte nëse shkelja nuk do të kishte ndodhur, IACtHR-ja ka referuar pagën minimale të aplikueshme në shtetin ku ka ndodhur shkelja, për të llogaritur një humbje të tillë.⁸⁸

⁸⁷Shih Parimet Themelore të OKB-së, paragrafi i nëntë i preambulës. Lidhur me jurisprudencën e IACtHR për këtë çështje, *shih Aloboetoe kundër Surinamit*, Reparacionet dhe shpenzimet, 10 shtator 1993, Seria C nr. 15, para. 83; *Masakra e Plan de Sánchez kundër Guatemalës*, Reparacionet dhe shpenzimet, Aktgjykimi i 19 nëntorit 2004, Seria C nr. 116, par. 86, 94-111; *Saramaka People kundër Suriname*, Kundërshtimet paraprake, meritat, dëmshpërblimet dhe shpenzimet, 28 nëntor 2007, Seria C nr. 172, par. 188, 190-202.

⁸⁸IACtHR *rasti i Institutit të Edukimit për të Mitur në Paraguaj*, *Parashtresat Paraprake, meritat, reparacionet dhe shpenzimet*, Aktgjykimi i 2 shtatorit 2004, Seria C nr. 112, para. 288..

- 71.** Nga ana tjetër, masat e kënaqshmërisë sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut luajnë një rol qendror në dhënien e reparacioneve, ndryshe nga karakteri i tyre i veçantë në gjykimin ndërshtetëror. Sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, kënaqësia i referohet një sërë masash që shteti duhet t'i përmbahet për të korrigjuar dëmin dhe për të rivendosur dinjitetin e personit që është prekur nga shkeljet;⁸⁹ në këtë kuptim, IACtHR ka përmendur se ata duhet të kenë pasoja publike.⁹⁰ Në përputhje me rrethanat, masa të tilla si zbulimi publik i së vërtetës, përveç që janë të rëndësishme për rivendosjen e dinjitetit të atyre që preken direkt nga shkelja, mund të jenë thelbësore për procesin e shërimit të të gjithë komuniteteve.
- 72.** Megjithëse jo-ekzistente si një formë e dëmshpërblimit sipas të drejtës së përgjithshme ndërkombëtare, rehabilitimi sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut është shumicën e kohës i nevojshëm për korrigjimin e dëmeve të shkaktuara nga shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut.⁹¹ Është nën këtë formë të reparacionit që ideja e “kthimit të plotë” mund të materializohet⁹² nëse rehabilitimi interpretohet si një masë holistike e cila jo vetëm që përfshin kujdesin fizik dhe psikologjik, por edhe shërbimet sociale dhe financiare që mund të përfshijnë komunitetin ku i takon viktimat.
- 73.** Së fundi, një masë tjetër që ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut ka miratuar për të dhënë reparacione të plota është garancia e mospërsëritjes. Sipas ligjit ndërkombëtar, është kontestuar nëse garancitë e mos përsëritjes janë një masë e reparacionit ose një pasojë tjetër e përgjegjësisë së Shtetit.⁹³ Megjithatë, sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, ato luajnë një rol të rëndësishëm në sjelljen e disa lehtësimeve për viktimat. Garancitë e mos përsëritjes, së bashku me masat e

⁸⁹ Parimet bazë të OKB-së, parimi 22.

⁹⁰ IACtHR, Rasti i masakrës së Plan de Sánchez, shënimi i sipërm 86, para. 93.

⁹¹ Shih Parimet Themelore të OKB-së, parimi 21; dhe Deklarata e Drejtësisë për Viktimat, parimi 14.

⁹² Shih REDRESS Rehabilitimi si një formë e dëmshpërblimit sipas të drejtës ndërkombëtare, hulumtim nga Clara Sandoval, dhjetor 2009.

⁹³ Komentet, art. 30, para. 9.

rehabilitimit janë pa dyshim format më të gjera të dëmshpërblimit që mund të jepen për të korrigjuar një shkelje të të drejtave të njeriut, me masa të tilla si reforma institucionale, verifikimi, trajnimi i personelit të policisë dhe programet zhvillimore. Është gjithashtu përdorimi i kësaj mase të reperacionit që disa organizma ndërkombëtarë kanë synuar në materializimin e reparacioneve transformuese. Këto të fundit janë masa që kërkojnë të adresojnë rrënjët dhe shkaqet strukturore të shkeljeve.⁹⁴

Parimet e Reparacionit sipas të Drejtës Ndërkombëtare Penale

- 74.** Çdo procedurë penale që konsiderohet respektuese e standardeve të të drejtave të njeriut, përveç identifikimit dhe ndëshkimit të atyre që janë përgjegjës për krimet e kryera, duhet të synojë të riparojë pasojat e krimeve. Statuti i Romës dhe Rregullat e Procedurës dhe Provave të ICC-së (*International Criminal Court / Gjkata Ndërkombëtare Penale*) sigurojnë një kuadër të përshtatshëm ligjor për të përmbushur këtë qëllim. Do të ishte padyshim e rëndësishme për të shqyrtuar zgjedhjet rregullatore të bëra në bazë të Statutit të Romës dhe praktikës së ICC-së.
- 75.** Parimi i proporcionalitetit nuk është eksplicit në rregulloret e ICC, por neni 75.1 i Statutit të Romës thotë se Gjkata mund të përcaktojë fushëveprimin dhe shtrirjen e çdo dëmi, humbjeje dhe dëmtimi në procedurat e reparacionit. Gjithashtu, neni 97 i Rregullave të Procedurës dhe Provave thekson se ICC mund të emërojë ekspertë për të përcaktuar fushëveprimin dhe shtrirjen e dëmit, humbjes dhe lëndimit, lidhur me vlerësimin e reparacioneve.
- 76.** Parimi i kauzalitetit duhet të zbatohet në mënyrë korrekte nga ICC, duke marrë parasysh shkallën e dëmit të shkaktuar viktimave dhe komuniteteve dhe marrëdhënien e saj (të drejtpërdrejt apo jo) me krimet dhe sjelljen e kryer nga

⁹⁴ Rama Mani, "Reparation as a component of transitional justice: pursuing 'reparative justice' in the aftermath of violent conflict", in De Feyter, K., S. Parmentier, et al. (eds.), *Out of ashes: reparation for victims of gross and systematic human rights violations*, Intersentia, Antwerpen-Oxford, 2005, f. 78-79.

autori i supozuar. Këtu përfshirja e ekspertëve mund të jetë gjithashtu jetike për të krijuar një lidhje shkakësore që shkon përtej dëmeve materiale dhe që gjithashtu shikon me kujdes dëmet jo-materiale siç është niveli i traumës ose dëmi emocional.

- 77.** Për sa i përket arritjes së kompensimit të plotë ose *restitutio in integrum*, ICC gjithmonë do të merret me rastet e vështira nga perspektiva e dëmshpërblimit: nga njëra anë, për shkak të numrit të viktimave dhe vlerës së dëmit që kanë pësuar potencialisht; nga ana tjetër, sepse shkelësi nuk është një shtet, por një individ, me burime të kufizuara apo jo ekzistuese për të riparuar mizoritë për të cilat ai ose ajo është përgjegjës. Përveç kësaj, një individ i mungojnë aftësitë e shtetit për të zbatuar dëmshpërblimet e urdhëruara nga Gjykata, dhe ai / ajo me gjasë do të jetë në burg.
- 78.** Probleme të tjera praktike përfshijnë shtyrjen e shteteve për të bashkëpunuar dhe ndihmuar Gjykatën, për shembull, me konfiskimin e të ardhurave, pasurisë dhe asetëve së kryerësit. Për këto arsye, roli i Fondit të Mirëbesimit për Viktimat (TFV) është vendimtar për ICC-në që të përpiqet të ofrojë reparacione adekuate dhe efektive.
- 79.** Kufizimet që ICC ka në lidhje me aftësinë e saj për të dhënë kompensimin e plotë nuk ndikojnë në të drejtën e viktimave për të kërkuar reparacione para organeve të tjera për shkeljet e të drejtave të njeriut që mund të kenë vuajtur gjithashtu. Sipas nenit 75.6 të Statutit të Romës, të drejtat që rrjedhin nga ky instrument janë pa paragjykime të të drejtave të tjera që viktimat mund të kenë sipas traktateve të tjera.
- 80.** Lidhur me format e dëmshpërblimit, neni 75.1 i Statutit të Romës përmend kthimin, kompensimin dhe rehabilitimin si masa që mund të zbatohet ICC-ja. Megjithatë, deklarata nuk është e plotë, kështu që mund të urdhërohen forma të tjera të dëmshpërblimit, si p.sh. satisfaksioni (kënaqësia). Sidoqoftë, për shkak të vështirësive të përshkruara më lart në lidhje me kapacitetin e kryerësit që të veprojnë në përputhje me masat e reparacionit dhe për shkak të kapacitetit të

